



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr _____

_____г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafit 1 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 12/2019) dhe nenit 40 paragrafi 3 të Rregullores së Punës së Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsioni, Duke vepruar sipas lëndës së formuar pas denoncimit të paraqitur nga një parashtrues i njohur, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (në tekstin e mëtejme KSHPK) në seancën e 59-të të mbajtur më 14.01.2022 ka miratuar sa vijon

VENDIM

Procedura në lëndën me numër 12-4225/1 nga data 01.12.2020, e formuar pas denoncimit të dorëzuar për dyshimin për ndërtim pa leje, **NDËRPRITET**

Në përputhje me dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesave, KSHPK nuk ka elemente për veprim të mëtutjeshëm për arsie se vepron organ tjetër kompetent.

Lënda me numër 12-4225/1 të datës 01.12.2020 të mbyllet dhe të arkivohet.

Vendimi i në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

Arsyetim

Parashtruesi i njohur me datë 01.12.2020 ka bërë denoncim për dyshimin për ndërtim pa leje dhe është formuar lënda me numër 12-4225/1 nga 01.12.2020.

Denoncimi tregon dyshime për ndërtim pa leje në territorin e Komunës së ----- ku sipas denoncimit është duke u ndërtuar baza konkrete nga investitori ----- SHPKNJP, dhe pa leje ndertimi. Lidhur me këtë në denoncim theksohet se me datë 18.10.2018 është miratuar Vendimi nga inspeksioni ndërtimor në Komunën e ----- me të cilin është urdhëruar investitori që ta largojë objektin, por pas ankesës së tij Komisioni Shtetëror për vendosje në shkallë të dytë nga mbikqyrja inspektuese dhe procedurës së kundërvajtjes e anulon aktvendimin dhe lëndën e kthen në rigjykim, dhe thuhet se e njëjta përsëritet edhe në lidhje me vendimet e mëposhtme të komunës, gjithsej katër. Më tej thuhet se administrata komunale dhe ajo shtetërore

po e bartin rastin dhe ndërkohë vazhdon ndërtimi pa leje. Po ashtu thuhet se është hapur lëndë në Prokurorinë Themelore Publike në -----.

Me qëllim të verifikimit të pretendimeve dhe konstatimit të plotë të gjendjes faktike në lëndën e hapur, KSHPK ka dorëzuar kërkesë për dorëzim të të dhënave dhe informatave në Komunën e -----, Prokurorinë Themelore Publike ----- dhe Gjykatën Themelore -----.

Nga përgjigjet e marra nga institucionet konstatohet se Prokuroria Themelore Publike ----- me 24.02.2021 në Gjykatën Themelore ----- ka ngritur aktakuzë për veprën penale ndërtimi pa leje nga neni 244a paragrafi 1 i Kodit Penal kundër personit ----- nga -----.

Në Gjykatën Themelore në ----- është në procedurë penale pas aktakuzës së dorëzuar, lënda ka përfunduar dhe po vepohet, por në momentin e dorëzimit të përgjigjes _ë ende nuk është marrë vendim përfundimtar.

Nga sa u tha më lartë, KSHPK vlerësoi se ka vepruar dhe ka marrë masa organi kompetent për çka nuk ka elemente për veprime të mëtutjeshme dhe ka vendosur si në dispozitë të këtij vendimi.

Dorëzuar deri te:
Parashtruesi i denoncimit

Punoi: B.KSH

KOMISIONI SHITETËROR
PËR PARANDALIMIN E
KORRUPSIONIT
KRYETAR
Biljana Ivanovska

